



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHITES

MUNICIPALITY OF SHITE/ OPSTINA SHITLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE



ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Data/Datum/Date:	02.07.2026
Nr./Br./No	02/792
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shites-kryesuesi z.Rahman Jakupi
Përmes/Preko/Through:	z. Qemajl Aliu, kryetar i Komunës së Shites
Nga/Od/From:	Vlora Hyseni, kordinatore e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
Lënda/Predmet/Subject:	Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin Janar-Qershor 2026

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Shites, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, ka zhvilluar tri mbledhjet e parapara me legjislacionin në fuqi, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, trajtimit të çështjeve të sigurisë publike dhe krijimit të një mjedisi të sigurt për të gjithë qytetarët e komunës.

Ky raport është hartuar në bazë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, si dhe Planit Vjetor të Punës së KKSB-së, dhe paraqet aktivitetet, temat e trajtuara dhe rekomandimet gjatë kësaj periudhe.

KKSB është themeluar me Vendimin e Kryetarit të Komunës së Shites, Dr. Qemajl Aliu, me nr. prot. 02/148, të datës 19.02.2026.

Ky vendim është miratuar edhe nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e parë të rregullt, të mbajtur më 05.03.2026.

Për shkak të vonesës në konstituimin e Kuvendit Komunal dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, tri mbledhjet e para të KKSB-së u organizuan në tre muaj radhazi.

Të gjitha mbledhjet u kryesuan nga nënkryetari i Komunës së Shtimes, z.Adnan Ademi.

Mbledhja e parë u mbajt më 23.04.2026, me këtë rend dite:

- Shqyrtimi i ekstrakt-procesverbalit nga mbledhja e datës 22.12.2025;
- Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
- Zbatimi i masave për sigurinë në punë;
- Shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik në lagjet e qytetit dhe fshatrave;
- Të ndryshme.

Gjatë kësaj mbledhjeje, Komandanti i Stacionit Policor në Shtime, Haxhi Behluli, informoi se, bazuar në rastet e trajtuara dhe analizën e gjendjes së sigurisë, situata në komunë paraqitet e qetë dhe stabile, ndërsa rastet e evidentuara nuk kanë ndikuar në prishjen e rendit dhe sigurisë së përgjithshme.

Po ashtu, nga anëtarët e KKSB-së, u shqyrtuan edhe çështje të tjera me interes për qytetarët, nga ku u nxor rekomandimi drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike për shenjëzimin e vendndalesës së transportit të organizuar për nxënësit e Shkollës "Emin Duraku", në afërsi të ish-Stacionit Policor, në rrugën "Anton Çetta".

Ky rekomandim synon rritjen e sigurisë së nxënësve, organizimin më të mirë të transportit dhe uljen e rrezikut për këmbësorët.

Mbledhja e dytë u mbajt më 26.05.2026, me këtë rend dite:

- Shqyrtimi i ekstrakt-procesverbalit nga mbledhja e datës 23.04.2026;
- Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
- Zbatimi i masave për sigurinë në punë;
- Masat për trajtimin e qenve endacak;
- Të ndryshme.

Edhe në këtë mbledhje, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës raportuan se gjendja e sigurisë në Komunën e Shtimes vazhdon të jetë stabile.

Lidhur me zbatimin e masave për sigurinë në punë, u raportua se inspektorët komunalë janë vazhdimisht në terren, duke realizuar kontrolle në objektet me rrezikshmëri të lartë. Në këto aktivitete janë angazhuar edhe inspektorë nga niveli qendror dhe komunat fqinje, përfshirë Komunën e Ferizajt. Gjithashtu, u diskutua edhe çështja e trajtimit të qenve endacak, ku u theksua nevoja për gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe koordinimin ndërinstitutional për adresimin e këtij problemi.

Mbledhja e tretë u mbajt më 29.06.2026, duke përmbushur kështu obligimin ligjor për mbajtjen e tri mbledhjeve gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Rendi i ditës ishte:

- Shqyrtimi i ekstrakt-procesverbalit nga mbledhja e datës 26.05.2026;
- Informatë për gjendjen e sigurisë nga Policia e Kosovës;
- Informatë nga Njësia Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim në Shtime;
- Informatë nga Drejtoria e Arsimit;
- Të ndryshme.

Në këtë mbledhje u prezantuan informata të detajuara nga tri institucione kyçe të komunës, përkatësisht Policia e Kosovës, Njësia Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim dhe Drejtoria e Arsimit, të cilat paraqitën gjendjen aktuale dhe aktivitetet në fushat përkatëse. Nga diskutimet u nxorën disa rekomandime, ndër të cilat:

- Rekomandimi drejtuar institucioneve kompetente për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me deminimin e disa zonave në fshatin Carralevë;
- Rekomandimi, me kërkesë të Komandantit të Stacionit Policor në Shtime, për trajtimin dhe rehabilitimin e mëtejshëm institucional të personit H. Hoxha, i cili paraqet probleme të shëndetit mendor.

Të tri mbledhjet e mbajtura gjatë këtij gjashtëmujori janë karakterizuar nga diskutime konstruktive, transparencë dhe pjesëmarrje aktive e të gjithë anëtarëve të KKSB-së, duke kontribuar në identifikimin dhe trajtimin me kohë të sfidave të sigurisë në komunë.

Bazuar në punën e zhvilluar sipas vlerësimeve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtimes vazhdon të vlerësohet ndër këshillat më funksionale në nivel vendi. Ky vlerësim është rezultat i bashkëpunimit të mirë ndër-institucional, koordinimit efektiv ndërmjet institucioneve, pjesëmarrjes aktive të anëtarëve dhe angazhimit të vazhdueshëm për adresimin e çështjeve që ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve.

Përfundim

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, KKSB ka realizuar me sukses të gjitha obligimet e parapara ligjore dhe ato të Planit Vjetor të Punës. Përmes mbajtjes së rregullt të mbledhjeve, koordinimit institucional dhe nxjerrjes së rekomandimeve konkrete.

Për transparencë tuaj, të gjitha ftesat, procesverbalet, Plani i Punës dhe Vendimi për themelimin e KKSB-së janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.